

Nr. Prot. 054/B/19

VENDIM Nr. 1383

Për

Fillimin e procesit të Konsultimit Publik të draft dokumentit

“Draft Vendimit për Rregullimin e tarifave me shumicë dhe pakicë të Roamingut si dhe ato të terminimit të thirrjeve mobile në mes Republikës së Kosovës dhe Ballkanit Përendimor”

Në mbështetje të nenit 1, nenit 3, paragrafët 1) dhe 2), nenit 9, paragrafi 1), nenit 10, paragrafi 4), neni 64 paragrafi 1), nenit 79 paragrafët 1) dhe 2) dhe nenit 82, paragrafët 1) dhe 3) të Ligjit për Komunikimet Elektronike Nr. 04/L-109 (*tutje referuar si – Ligji ose LKE*) dhe nenit 13 paragrafi 1) dhe 5) i Statutit të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*tutje referuar si – Autoriteti ose ARKEP*), Bordi i Autoritetit i përbërë nga:

- | | |
|-----------------------|---------|
| 1) z. Kreshnik Gashi, | Kryetar |
| 2) z. Nijazi Ademaj, | Anëtar |
| 3) z. Hazir Hajdari, | Anëtar |
| 4) z. Bahri Anadolli, | Anëtar |
| 5) z. Shqiprim Pula | Anëtar |

pas shqyrtimit të Rekomandimit të përgatitur nga Grupi Punues (GP) për zbatimin për zbatimin e “Marrëveshjes për zvogëlimin e çmimeve të shërbimeve roaming për rrjetet publike të komunikimeve mobile në Regjionin e Ballkanit Përendimor” (Ref. Nr.Prot. 249/2/19) të nënshkruar ndërmjet Ministrive përgjegjëse për fushën e komunikimeve elektronike nga: Shqipëria, Bosnia dhe Hercegovina, Kosova, Maqedonia Veriore , Mali i Zi, dhe Serbia (*tutje referuar si – BP*) më datë 04 Prill, 2019, vendosi si më poshtë:

V E N D I M

- I. Miratohet fillimi i Konsultimit Publik të dokumentit ‘**Vendimi për Rregullimin e tarifave me shumicë dhe pakicë të roamingut si dhe ato të terminimit të thirrjeve mobile në mes Republikës së Kosovës dhe Ballkanit Përendimor**’.
- II. Procesi i konsultimit publik fillon më datë **24 Maj, 2019** dhe përfundon më **07 Qershor, 2019**.
- III. Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Neni 1 i Ligjit specifikon qëllimin e Ligjit si në vijim:

“Qëllimi i këtij ligji është rregullimi i aktivitetëve të komunikimeve elektronike bazuar në parimin e neutralitetit teknologjik dhe kornizën rregullatore të BE-së për komunikimet elektronike, duke promovuar konkurrencën dhe infrastrukturën efikase në komunikimet elektronike, si dhe garantimin e shërbimeve të duhura e të përshtatshme në territorin e Republikës së Kosovës.”

Po ashtu neni 9, paragrafi 1 specifikon si në vijim:

“Autoriteti ushtron funksionet në përputhje me këtë ligj dhe me aktet e tjera ligjore dhe nënligjore, si dhe në përputhje me politikat sektoriale kombëtare dhe strategjitë kombëtare të zhvillimit të komunikimeve elektronike dhe me marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e komunikimeve elektronike, ku aderon Republika e Kosovës.”

Ligji, respektivisht neni 10, paragrafët 4) përcakton se Autoriteti: *“Miraton legjislacionin sekondar lidhur me këtë ligj, të cilat janë në kompetencë të Autoritetit, mbështetur në dispozitat e këtij ligji.”*

Marrëveshja për zvoglimin e çmimeve të shërbimeve të roamingut për rrjetet publike të komunikimeve elektronike mobile në regjionin e BP, përcakton ndër të tjera se palët bien dakort që:

- të miratojnë jo më larg se më datën 01 Korrik 2019, çfarëdo ndryshimi të ligjeve/akteve nënligjore të tyre të komunikimeve elektronike të domosdoshme për të arritur objektivat e Marrëveshjes (Ref. neni 6 i Marrëveshjes).
- Amandamentet e nevojshme për të siguruar aplikimin e politikës së ndershme (Fair Use Policy), rregullat për implementimin e një mekanizimi të qëndrueshëm të derogimit dhe kërkesave për transparencë, të cilat korrespondojnë me rregulla të njëjta me ato të BE-së, do të jenë uniforme në të gjitha shtetet dhe miratohen jo më vonë se data 31 Dhjetor 2020.
- zbatimi i regjimit të ri të fillojë gradualisht nga data 01 Korrik 2019 (Ref. neni 1 i Marrëveshjes);
- zbatimi i kësaj marrëveshje do të koordinohet nga një organ/grup i krijuar nga përfaqësuesit e Rregullatorëve (Ref. neni 7 i Marrëveshjes).

Neni 82 i Ligjit përkufizon se Autoriteti gjatë aprovimit të akteve normative duhet t'i publikoj ato në pajtim me kushtet dhe procedurat e vendosura nga Autoriteti, duke ua ofruar mundësinë personave të interesuar që në afat të arsyeshëm kohor të shprehin pikëpamjet e tyre.

Andaj, Bordi i Autoritetit ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit.

Prishtinë, 24/05/2019

Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare

Kreshnik Gashi
Kryetar i Bordit

Aktivendimi i dërgohet:

- Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (MZHE),
- Autoritetit Kosovar të Konkurrencës (AKK),
- Ofruesve të shërbimeve të telefonisë mobile,
- Departamentit të Komunikimeve Elektronike,
- Departamentit Ligjor,
- Arkivës së Autoritetit.